

DOKUMENT MBI TRAJTIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në përputhje me nenin 13 të Rregullores UE 2016/679 ("Rregullorja" ose "DPPM") dhe të D.lgs. 196/2003, siç përshkruhet nga D.lgs. 101/2018

1. Titullari për trajtimin e të dhënave

Titullari për trajtimin e të dhënave është Grandi Navi Veloci S.p.A., me seli ligjore në Palermo, Calata Marinari d'Italia, kodi fiskal dhe TVSH n.13217910150 (më tej i quajtur "GNV" ose "Titullar").

Titullari mund të kontaktohet duke shkruar në adresën: direzione@pec.gnv.it

Titullari ka emëruar një Përgjegjës për Mbrojtjen e të dhënave personale (Data Protection Officer - DPO -) i cili mund të kontaktohet për çdo lloj informacioni ose kërkesë në adresën: e-mail: dpo@gnv.it

2. Lloji i të dhënave

Titullari përpunon, mbledh dhe/ose merr informacione në lidhje me të interesuarin si për shembull: emri, mbiemri, adresa fizike, kombësia, provinca dhe komuna e banimit, telefoni fiks dhe/ose celulari, fax/i, kodi fiskal, adresa/t e-mail, dokumenti i identitetit; IBAN, të dhënat bankare/postare dhe kartat e kreditit, Log, adresa IP e prejardhjes (për shërbimet e përfituara përmes portalit web të GNV).

3. Qëllimi i trajtimit

Titullari ju informon mbi trajtimin e të dhënave tuaja personale dhe mbi të drejtat tuaja, në mënyrë që të mund të shprehni pëlqimin tuaj në mënyrë të ndërgjegjshme, aty ku kërkohet.

Të dhënat tuaja personale (të dhëna nga ju, nga palët e treta ose të marra, brenda kufijve të ligjit, nga listat publike) mund të përpunohen për qëllimet e mëposhtme:

1 – përmbushje e detyrimeve të parashikuara nga ligji, mbi bazën juridike të nenit 6.1.c) DPPM: domethënë për të përmbushur detyrimet e parashikuara nga ligji, nga një rregullore komunitare, si dhe nga dispozitat e lëshuara nga Autoritetet e legjitimuara me ligj ose nga Organet kompetente të mbikëqyrjes ose kontrollit (në këtë rast pëlqimi Juaj nuk është i nevojshëm pasi trajtimi i të dhënave është i lidhur me përmbushjen e këtyre detyrimeve/dispozitave);

2 – ekzekutimi i detyrimeve kontraktuale të shitjes dhe asistencës, mbi bazën juridike të nenit 6.1.c) DPPM: domethënë për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontratat në të cilat Ju jeni pjesë ose për të përmbushur, para ose pas përfundimit të kontratës, kërkesat tuaja specifike, edhe nëpërmjet teknikave të komunikimit në distancë, duke përfshirë një call center dhe asistencën Customer Care (në këtë rast pëlqimi Juaj nuk është i nevojshëm, pasi trajtimi i të dhënave është funksional për menaxhimin e marrëdhënies ose për ekzekutimin e kërkesave);

3 – mbrojtjet: për të vërtetuar, ushtruar ose mbrojtur një të drejtë në selinë juridike, mbi bazën juridike të neneve 6.1.f) dhe 9.2.f) DPPM;

4 – administrimi i pjesëmarrjeve në gara me çmime, mbi bazën juridike të nenit 6.1.c) DPPM: dorëzimi i të dhënave është i nevojshëm, pasi në mungesë të tyre, nuk do të jetë e mundur pjesëmarrja në garë (një refuzim i mundshëm ka si pasojë përjashtimin e konkurrentit nga procedura e lartpërmendur);

5 – tregtare: me pëlqimin tuaj paraprak, sipas nenit 6.1.a) të DPPM për t'ju ofruar informacion (përfshirë përmes teknikave të komunikimit në distancë të automatizuara ose jo si për shembull, me korrespondencë postare, telefonata edhe nëpërmjet sistemeve të telefonatave të automatizuara, telefaksit, postës elektronike, SMS ose MMS ose lloje të tjera të mesazheve) mbi produktet, shërbimet ose nismat e Grandi Navi Veloci SpA ose palëve të treta, për të promovuar këta të fundit, për të kryer kërkime të tregut edhe përmes aktiviteteve të profilizimit dhe/ose duke kontrolluar cilësinë e produkteve ose shërbimeve që ofrohen (duke telefonuar ose dërguar pyetësorë);

6 – tregtare ose shitje e drejtpërdrejtë e produkteve ose shërbimeve të GNV analogë me ata të blerë nga Ju: në lidhje me këtë, saktësohet se Titullari mund të përdorë, pa pëlqimin Tuaj, adresat e postës elektronike dhe postën me letër të dhënë nga ju në kontekstin e shitjes së një produkti ose shërbimi. Baza juridike e trajtimit për të dhënat Tuaja për këto qëllime është interesi ligjor i Titullarit sipas nenit 6.1.f) të DPPM. Në çdo rast, sipas nenit 21 të DPPM, Ju keni mundësinë që të kundërshtoni këtë trajtim në çdo kohë, fillimisht ose në rast komunikimesh të mëtejshme, në mënyrë të thjeshtë dhe falas edhe duke i shkruar Titullarit në këtë email: dpo@gnv.it;

7 - profilimi: me pëlqimin Tuaj, sipas nenit 6.1.a) të DPPM, për analizimin e zgjedhjeve Tuaja të blerjeve dhe preferencave Tuaja të sjelljes, on-line dhe off-line, për të strukturuar sa më mirë komunikimin dhe propozimet tregtare të personalizuara, për të optimizuar vetë ofertën (edhe përmes analizave të fokalizuara dhe të përzgjedhura), për të kryer analiza të përgjithshme me qëllim orientimin strategjik ose inteligjence tregtare dhe në përgjithësi për aktivitetin e profilimit.

Dhënia e të Dhënave tuaja Personale për qëllimet sipas numrave 2,4 dhe 6 është fakultative. Në rast refuzimi nuk vërtetohet asnjë pasojë përveçse për qëllimet a), në krahasim me të cilën, mungesa e dhënies nuk do të mundësojë ekzekutimin e detyrimeve kontraktuale të shitjes dhe asistencës nga ana e Titullarit.

Saktësohet se në lidhje me qëllimet e përshkruara tregtare sipas numrit 4 që Titullari mbledh një pëlqim të vetëm sipas Marrëveshjes së Përgjithshme të Garantit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Linjat udhëzuese në lidhje me aktivitetin promovues dhe kontrastin ndaj spam-it" të datës 4 korrik 2013.

4. Fidelity Card - Karta e Besnikërisë

Në kuadrin e programit të besnikërisë GNV, trajtimi i të dhënave ka për qëllim zhvillimin e këtyre veprimeve:

- a) lëshimin e kartës Fidelity Card dhe administrimin e aktiviteteve që nuk mund të ushtrohen në mënyrë anonime dhe të nevojshme për të lejuar personat që e nënshkruajnë që të përdorin dhe njohin zbritjet e çmimeve dhe promovimet, të marrin pjesë në grumbullimin e pikëve dhe të kenë akses në përdorimin e shërbimeve të tjera ndihmëse nëpërmjet Kartës;
- b) kryerjen, me pëlqimin Tuaj të dhënë me shkrim, e aktiviteteve të marketingut të drejtpërdrejtë, si p.sh. dërgimin - nëpërmjet postës elektronike e-mail, SMS dhe MMS - ose instrumenteve jo të automatizuara si posta me letër dhe telefoni me operator - të materialeve publicitare dhe të komunikimeve me përmbajtje informative dhe/ose promovionale në lidhje me produktet ose shërbimet e furnizuara dhe/ose të Titullarit;
- c) kryerjen, me pëlqimin Tuaj të dhënë me shkrim, e aktiviteteve të profilimit individual ose të grumbulluara për kërkimet e tregut që synojnë, për shembull, analizën e zakoneve dhe zgjedhjeve të konsumit, në përpunimin e statistikave në lidhje me to ose vlerësimin e shkallës së kënaqësisë karshi produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

Për qëllimet e përmendura në germën a) të pikës së mëparshme, dorëzimi i të dhënave nuk është i detyrueshëm, por përbën një kusht të nevojshëm dhe të domosdoshëm për lëshimin e kartës Fidelity Card: prandaj mungesa e dorëzimit të të dhënave sjell si pasojë pamundësinë për aplikuesin që të marrë Kartën.

Për qëllimet e përmendura në germën b) dhe c) të pikës së mëparshme, dorëzimi i të dhënave nuk është i detyrueshëm dhe refuzimi i mundshëm për të dorëzuar të dhëna të tilla dhe dhënia e pëlqimit përkatës do ta bëjë të pamundur për Titullarin që të zhvillojë aktivitetet e marketingut të drejtpërdrejtë dhe profilizimit të treguar në të, por nuk do të rrezikojë mundësinë që aplikuesi të përfitojë lëshimin e kartës Fidelity Card dhe të ketë qasje në benefiset që kanë lidhje me të.

5. Kujt i destinohet dhe transferimi i të dhënave

Të dhënat personale do të mund t'i komunikohen:

- ose personeli i ngarkuar me trajtimin sipas nenit 29 të DPPM;
- ose subjektet, njësitë ose autoritete, titullarët e pavarur për trajtimin, të cilëve u duhen komunikuar me detyrim të Dhënat Tuaja Personale sipas ligjeve në fuqi ose urdhrave të autoriteteve (organet e vigjilencës, autoritetet juridike, kompanitë e sigurimit për shërbimet e sigurimit);
- subjekteve që veprojnë zakonisht në cilësi të përgjegjësve për trajtimin sipas nenit 28 të DPPM; lista a përditësuar dhe e plotë mund t'i kërkohet Titullarit duke e kontaktuar në të dhënat më sipër.

Për sa i përket transferimit të mundshëm të të Dhënave Personale drejt vendeve të treta, Shoqëria bën me dije se trajtimi do të ndodhë sipas njëres prej mënyrave të mundësuar nga ligji në fuqi, si për shembull pëlqimi i të interesuarit, përdorimi i Klauzolave Standard të aprovuara nga Komisioni Evropian, përzgjedhja e subjekteve që marrin pjesë në programe ndërkombëtare për qarkullimin e lirë të të Dhënave Personale (p.sh. EU-USA Privacy Shield) ose që veprojnë në Shtetet e konsideruara të sigurta nga Komisioni Evropian. Mund të merren më shumë informacione, në rast se kërkohen, pranë Titullarit në kontaktet e lartpërmendura.

6. Ruajtja dhe mënyra e trajtimit

Sigurohet që të gjitha trajtimet e të dhënave do të bazohen në parimet e vendosura nga DPPM-ja, duke pasur parasysh në veçanti ligjshmërinë, korrektësinë dhe transparencën e trajtimit, përdorimin e të dhënave për qëllime specifike, të qarta dhe legjitime, në një mënyrë të përshtatshme në lidhje me trajtimin, duke respektuar parimet e minimizimit të të dhënave, saktësinë, kufizimin e ruajtjes, integritetin dhe konfidencialitetin, përgjegjësimin (neni 5 i Rregullores).

Të dhënat personale përpunohen përmes veprimeve të mëposhtme: grumbullimit, regjistrimit, organizimit, strukturimit, ruajtjes, konsultimit, adaptimit ose modifikimit, përdorimit, shpërndarjes, zbulimit përmes transmetimit, rikuperimit, shtrirjes, kombinimit, kufizimit, fshirjes dhe shkatërrimit të të dhënave.

Të dhënat personale i nënshtrohen përpunimit me letër dhe elektronik.
Titullari do të trajtojë të dhënat personale për kohën e nevojshme për të realizuar qëllimet e treguara më sipër.

7. Të miturit

Shërbimet tona, sitet web dhe aplikacionet nuk janë destinuar për një përdorim të drejtpërdrejtë nga ana e të miturve. Është e nevojshme të keni mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç për të përdorur shërbimet dhe për të kryer veprime në sitin tonë web dhe në aplikacionin tonë. . Pa pëlqimin e personit që ushtron të drejtën prindërore ose kujdestarit (përveç rasteve kur lejohet nga ligji i aplikueshëm), ne nuk do të marrim informacione personale nga të miturit, për aq sa ne e dimë. Duke kryer transaksione me ne, deklaroni automatikisht se jeni tetëmbëdhjetë vjeç dhe keni autoritet të plotë për të ekzekutuar transaksione të tilla dhe për t'u lidhur me to ligjërisht.

Nëse informohemi ose marrim vesh se një person i mitur na ka dorëzuar të dhënat e tij personale, ne do t'i eliminojmë menjëherë këto të dhëna personale.

8. Të drejtat e të interesuarit

Në cilësinë e palës së interesuar në përpunimin e të dhënave në fjalë, ju keni të drejtat e mëposhtme njohëse dhe të kontrollit siç parashikohen nga DPPM.

TË DREJTA NJOHËSE	
E drejta për dokumentacionin informues nenet. 12 , 13 , 14 <i>duke konsideruar 58, 60</i>	Të interesuarit kanë të drejtë të marrin informacione të sakta mbi trajtimin e të dhënave të tyre personale. Dokumentacioni informues duhet të përmbajë këto informacione: <ul style="list-style-type: none"> • Identitetin e titullarit; • Të dhënat e kontaktit Data protection officer – DPO; • Qëllimin e trajtimit; • Baza juridike; • Interesin e mundshëm ligjor që përbën bazën juridike; • Detyrime të mundshme ligjore ose kontraktuale në bazë të të cilave do të jepen; • Rrethanat e qarkullimit të të dhënave (BE apo jashtë BE-së); • Kohëzgjatja e trajtimit; • Procesin (e mundshëm) vendimtar në bazën e trajtimit të automatizuar; • Të drejtat e të interesuarit: hyrja, ratifikimi, integrimi, fshirja, kufizimi, kundërshtimi, mbajtja, ankesat praj Autoritetit të Kontrollit, heqja e konsensusit.
E drejta për akses neni 15 <i>duke konsideruar 63</i>	Pala e interesuar ka të drejtë të marrë nga titullari për trajtimin e të dhënave konfirmimin nëse është duke u kryer apo jo një trajtim i të dhënave që i përkasin dhe, në këtë rast, do t'i jepet akses në të dhënat personale
TË DREJTAT PËR KONTROLL	
E drejta për të anuluar dhe integruar neni. 5 (1) (d), 16 <i>duke konsideruar 39, 59, 65, 73</i>	Pala e interesuar ka të drejtë të marrë nga titullari për trajtimin e të dhënave anulimin e të dhënave të pasakta personale në lidhje me të pa vonesa të panevojshme. Duke marrë parasysh qëllimet e trajtimit, pala e interesuar ka të drejtë të përfitojë integrimin e të dhënave personale jo të plota, madje edhe duke dhënë një deklaratë plotësuese.
E drejta për fshirjen dhe harresën neni 17 <i>duke konsideruar 65-66, 68</i>	Pala e interesuar ka të drejtë të marrë nga kontrolluesi i të dhënave fshirjen e të dhënave personale në lidhje me të pa asnjë vonesë të pajustificuar dhe titullari i të dhënave ka detyrimin të fshijë të dhënat personale pa vonesa të pajustificuara, nëse ekziston një nga arsyet e përmendura në paragrafin 1 të nenit 17 të Rregullores.
E drejta për kufizim neni 18 <i>duke konsideruar 67</i>	Subjekti i të dhënave ka të drejtë të marrë kufizimin e trajtimit nga titullari i të dhënave kur ekzistojnë rrethanat e caktuara.
E drejta për kundërshtim neni 21 <i>duke konsideruar 50, 59, 69 -70, 73</i>	Pala e interesuar ka të drejtë të kundërshtojë në çdo kohë, për shkaqe që lidhen me situatën e tij/saj të veçantë, trajtimin e të dhënave personale në lidhje me të, sipas Nenit 6, paragrafi 1, shkronjat e) ose f), duke përfshirë profilizimin në bazë të këtyre dispozitave. Titullari për trajtimin e të dhënave nuk pranon të trajtojë më tej të dhëna personale, me përjashtim të hipotezës se ekzistojnë arsye që e legjitimojnë trajtimin dhe këto arsye mbizotërojnë mbi të drejtën e palës së interesuar për të kundërshtuar.
E drejta për mbajtje neni 20	Bëhet fjalë për një të drejtë të re.

<p><i>duke konsideruar 68, 73</i></p>	<p>Pala e interesuar ka të drejtë të marrë në një format të strukturuar, të përdorur zakonisht si dhe të lexueshëm nga një pajisje automatike, të dhënat personale që i përkasin të cilat duhet t'i sigurohen nga titullari për trajtimin e tyre.</p> <p>Ai gjithashtu ka të drejtë t'ia transmetojë këto të dhëna një titullari tjetër për trajtimin e të dhënave pa pengesa nga titullari i të dhënave që ia ka dhënë ato, nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përpunimi bazohet mbi pëlqimin në përputhje me nenin 6 paragrafi 1, shkronja a) ose nenin 9, paragrafi 2, shkronja a) ose me një kontratë sipas Nenit 6, paragrafi 1, shkronja b); dhe • mbi faktin nëse trajtimi është kryer me mjete të automatizuara. <p>Për të drejtën e transportueshmërisë është dhënë një opinion specifik nga Grupi i Punës WP 29</p>
<p>E drejta për të kundërshtuar dhe vendimet e bazuara vetëm në përpunimin e të dhënave</p>	<p>Nëse të dhënat personale trajtohen për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë, subjekti i të dhënave ka të drejtë të kundërshtojë në çdo kohë trajtimin e të dhënave personale që i përkasin atij për këto qëllime, duke përfshirë edhe profilizimin në masën në të cilën është e lidhur me një marketing të tillë të drejtpërdrejtë.</p>
<p>Neni. 21 presja 2,3 neni 22 <i>duke konsideruar 70</i></p>	<p>Subjekti i të dhënave ka të drejtë të mos i nënshtrohet një vendimi të bazuar vetëm mbi trajtimin e automatizuar, duke përfshirë edhe profilizimin, i cili prodhon efekte ligjore që e prekin atë ose që ndikon dukshëm në personin e tij.</p>

Prandaj, si një palë e interesuar, ju keni të drejtat e parashikuara nga artikujt 15 - 21 të DPPM-së, si dhe të drejtën për të parashtruar ankesë tek Autoriteti Kompetent sipas nenit. 77 të DPPM-së.

9. Procedura për ushtrimin e të drejtave dhe komunikimeve

Pala e interesuar mund të dërgojë një kërkesë zyrtare për të ushtruar të drejtat e veta ose një sinjalizim për mosplotësimin ose shkeljen e hamendësua, duke dërguar një e-mail në: dpo@gnv.it

Titullari për trajtimin e të dhënave merret me menaxhimin dhe ekzekutimin e kërkesave për ushtrimin e të drejtave në përputhje me DPPM.

Saktësojmë se:

- Afati i fundit për respektimin e kërkesës së palës së interesuar është 30 ditë dhe mund të zgjatet me 60 ditë të tjera, nëse është e nevojshme, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe numrin e kërkesave. Në këtë rast, Titullari informon palën e interesuar për zgjatjen dhe arsyet e vonës, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës.
- Informacioni i dhënë nga pala e interesuar dhe çdo komunikim dhe veprime të ndërmarra janë falas.
- Nëse kërkesat e palës së interesuar janë qartësisht të pabazuara ose të tepruara, veçanërisht për shkak të natyrës së tyre të përsëritshme, titullari për trajtimin e të dhënave mund të:
 - a) të kërkojë pagesën e një tarife të arsyeshme duke marrë parasysh shpenzimet administrative të bëra për të siguruar informacionin ose komunikimin ose të ndërmarrë veprimet e nevojshme; ose
 - b) të refuzojë respektimin e kërkesës.

Për çdo sqarim ose kërkesë në lidhje me trajtimin e të dhënave personale, është e mundur të kontaktoni kontrolluesin e të dhënave ose DPO në adresën e e-mailit të treguar më lart në çdo kohë.